



Prishtinë: 23.01.2013

Kodi i ZRRE-së: V\_498\_2013

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_886\_12\_12

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_886\_12\_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 03.01.2013.

**Në mbledhjen e mbajtur më 23 janar 2013 nxori këtë:**

### **VENDIM**

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A.Sh. (shifra në KEK: DPR - 10947), Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_886\_12\_12 i datës 13.12.2012.

### **Arsyetim**

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 26.05.2004 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 10948 dhe se gjatë këtij inspektimit kanë konstatuar se konsumatori e ka hequr njehsorin elektrik mbasi ka pasur dy njehsor, dhe se njërin e ka ndërruar me njehsor të ri, ndërsa njehsori elektrik nr. 2245170 është shkyçur nga rrjeti i tensionit të ulët, pra është pasivizuar. Punëtorët e KEK-ut po ashtu kanë evidentuar se duhet të pasivizohet edhe në faturim. Punëtorët e KEK-ut prapë me datë 19.09.2005 kanë bërë inspektimin e pikës matëse te konsumatorit me shifër DPR – 10948 dhe gjatë inspektimit kanë konstatuar se konsumatori ka pasur dy njehsor elektrik, njërin me numër 2245170 në shifrën DPR - 10948 i cili është larguar apo demontuar, si dhe njehsorin elektrik me numër 36239319 në shifrën DPR – 10947, pra tani njehsori elektrik nr. 36239319 regjistron shpenzimet e dy banesave dhe se borxh i shifrës DPR – 10948 të bartet në shifrën DPR – 10947.

Me datë 18.12.2006 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse gjatë inspektimit të pikës matëse kanë hasur në konsumatorin me numër njehsori 2245170, Iskra, 1975, me gjendje TL= 92249 kWh (tarifa e lartë) dhe TU= 85653 kWh (tarifa e ulët), e cila është pa vulë distributive. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë evidentuar se konsumatori i njëjtë ka shpenzuar energji elektrik në Prishtinë dhe se i njëjti bënë shpenzim të energjisë elektrik në Veternik, Hajvali, andaj konsumatorit duhet t'i bëhet ndërrimi i shtegut të furnizimit dhe adresa e banimit. Sipas punëtorëve të KEK-ut shtegu i furnizimit është 901001 Veternik, dhe gjendet afër shifrës DPR – 90039005, si dhe po ashtu kanë kërkuar të ndërrohet grupi tarifor nga 4/02 në 7/02.



Me datë 18.06.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar deklaratën e specialistit të daljes, sipas së cilës nga momenti i leximit të shtegut nuk ka mundur të gjendet ky konsumator.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 23.10.2012 përmes urdhër lejimit/ngarkimit nr. 44218 ka bartur borxhin nga shifra DPR - 10948 në shifrën DPR - 10947 bazuar në procesverbalin e inspektimit nr. 1710029 të datës 18.06.2012 në vlerë prej 376.65€. Pas kësaj ngarkese të bërë nga Departamenti i Faturimit në KEK, konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK duke kundërshtuar këtë ngarkesë. Departamentin për Konsumator në KEK me datë 30.10.2012 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e inspektimit nr. 1710029.

Pas përgjigjes së KEK-ut, konsumatori brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 12.12.2012 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR - 10947 nga urdhër lejimi/ngarkimi nr. 44218 i datës 23.10.2012 në vlerë 376.65€.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së me datë 03.01.2013 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është për faktin se DMK gjatë vendosjes së kësaj lënde ka bërë gabimisht vlerësimin e provave dhe shkresave të lëndës pasi që sipas KEK-u nuk është kontestuese se konsumatori ka pasur dy njehsor elektrik dhe se njërin njehsor elektrik nr. 2245170 e kanë shkyçur nga furnizimi dhe se ky njehsor elektrik është pasivizuar. Në vazhdim të ankesës KEK-u thekson se me rastin e kontrollimit të pikës matëse me datë 19.09.2005 punëtorët e KEK-ut kanë konstatuar se njehsori nr. 2245170 është asgjësuar dhe është propozuar që shpenzimet e njehsorit në shifrën DPR – 10948 të barten në shifrën DPR – 10947 të njehsorit elektrik i cili ka qenë duke furnizuar dy banesat lidhje jo e lejuar. Gjithashtu KEK-u thekson se nuk është kontestuese se punëtorët e KEK-ut gjatë inspektimit të pikës matëse në teren në Veternik-Hajvali kanë hasur në njehsorin i cili më parë ka qenë i vendosur në Prishtinë te konsumatori i lartcekur dhe pa i shfrytëzuar procedurat mbi transferin e njehsorit e ka bartur në Veternik dhe atë në lokal dhe se për njehsor është përgjegjës vet konsumatori, si dhe si nuk ka bërë konsumatori kërkesë në KEK apo polici se dikush ia ka marrë njehsorin.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23 janar 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit të KEK-ut, me të cilën pretendohet se DMK gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së konstaton se pretendimet e KEK të theksuara në ankesë nuk tregojnë dhe nuk argumentojnë saktë shkeljet e bëra nga DMK.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar procesverbalin e KEK-ut nr. 2125 të datës 25.05.2004 dhe ka vërejtur se punëtorët e KEK-ut kanë bërë shkyçjen e njehsorit elektrik nr. 2245170 të shifrës DPR – 10948 pasi që konsumatori ka pasur dy njehsor elektrik dhe se me këtë rast pasi është bërë shkyçja e njehsorit elektrik të lartcekur KEK-u edhe ka pasivizuar këtë shifër dhe se kjo më së miri vërehet në transaksionet e konsumatorit të po kësaj shifre.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe procesverbalin e KEK-ut nr. 001393 të datës 19.09.2005 dhe sipas analizës së procesverbalit vërehet se nuk evidentohet se njehsori elektrik nr. 2245170 është asgjësuar, por në procesverbal konstatohet se konsumatori ka pasur dy njehsor elektrik, ku njehsori elektrik me nr. 2245170 i cili është i regjistruar në shifrën DPR - 10948 është demontuar dhe se tani njehsori elektrik nr. 36239319 është i regjistruar në shifrën DPR – 10947 dhe se regjistron shpenzimet e dy banesave, madje KEK-u kërkon që borxh i shifrës DPR - 10948 të bartet në shifrën DPR – 10947.



Po ashtu duhet theksuar se gjatë analizës së këtij procesverbali ku KEK-u në ankesë thekson se njehsori elektrik nr. 2245170 është asgjësuar, punëtorët e KEK-ut kanë evidentuar në procesverbal njehsorin elektrik nr. 2245170 me gjendje: TL=50095 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=85653 kWh (tarifa e ulët), ku sipas kësaj vërehet se kjo gjendje nuk ka ndryshuar me atë inspektimit të KEK-ut të datës 26.05.2004.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe procesverbalin e KEK-ut të datës 18.12.2006 dhe ka vërejtur se procesverbali nr. 007163 i datës 18.12.2006 ka përsëritur adresën e konsumatori I.Sh. në “Kodrën e Diellit” 13.Kodra e Diellit, rr: Afrim Zhitija, BL-V-Hyr I, nr.2”, si dhe ka evidentuar shifrën e vjetër DPR – 10948, ndërsa ka dhënë këtë konstatim: gjatë inspektimit kanë hasur në konsumatorin me numër njehsori 2245170, Iskra, 1975, me gjendje TL= 92249 kWh (tarifa e lartë) dhe TU= 85653 kWh (tarifa e ulët), e cila është pa vulë distributive, si dhe kanë evidentuar se konsumatori i njëjtë ka shpenzuar energji elektrik në Prishtinë dhe se i njëjti bënë shpenzim të energjisë elektrik në Veternik, Hajvali, andaj konsumatorit duhet t’i bëhet ndërrimi i shtegut të furnizimit dhe adresa e banimit. Sipas këtij procesverbali vërehet se punëtorët e autorizuar të KEK-ut nuk kanë respektuar procedurat e inspektimit duke mos saktësuar nëse njehsori elektrik ka qenë i kyçur në rrjet gjatë këtij inspektimi si dhe duke mos evidentuar adresën e saktë të pikës kyçëse. Madje sipas specialisti i daljes Xh. D. ka deklaruar se nga periudha që ai lexon shpenzimet e njehsorëve elektrik (periudha 10 mujore) në shtegun, Veternik, Hajvali, nuk ka mundur që ta gjejë konsumatorin I.Sh. me shifër DPR - 10948 numër njehsori 2245170. Ky procesverbal është mjaft i paqartë dhe nuk është precizuar saktë se për çfarë pike matëse kemi të bëjmë.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimet e energjisë elektrike të shifrës DPR – 10948 dhe gjatë analizimit ka vërejtur se konsumatori është faturuar në mënyrë të rregullt deri në periudhën 05/2004 sipas shpenzimeve reale mujore të regjistruara, pastaj nga periudha 05/2004 deri në periudhën 01/2007 në transaksionet e konsumatorit nuk ka asnjë të dhënë të regjistruar, pra nuk ka asnjë faturë të energjisë elektrike të evidentuar. Nga transaksionet e konsumatorit vërehet se kjo shifër ka qenë pasive gjatë kësaj kohe, përveç një korrigjimi të bërë me datë 07.10.2005 në vlerë (-24 €), me të cilën edhe është barazuar vlera e borxhit të papaguar deri në periudhën 26.07.2004 dhe kjo vlerë është bartur nga shifra DPR – 10498 në shifrën e konsumatorit DPR – 10497.

Është analizuar edhe kontrata e për shitblerjen e pronës lidhur mes tij dhe shitësit Janicevic Zvonko të datës 24.10.2001 e cila është e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 08.11.2001. Bazuar kontratën e lartcekur vërehet që I.Sh. nga Prishtina është blerës i vetëm i patundshmërisë e cila gjendet në Prishtinë, “Aktash II” BL-IV, Hyr-1, banesa numër 11 me sipërfaqe prej 33.84 m<sup>2</sup>.

Bordi i ZRRE-së konsideron se DMK ka vepruar konform dispozitave ligjore në rastin e aprovimit të ankesës së konsumatorit A.Sh. me shifër DPR – 10947 me të cilën është kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR - 10947 nga urdhër lejimi/ngarkimi numër 44218 i datës 23.10.2012 në vlerë 376.65€.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së gjatë nxjerrjes së vendimit, por që KEK vetëm është thirrur në formën e përgjithësuar pa konkretizuar decidivisht se ku janë bërë shkeljet gjatë nxjerrjes së këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23.01.2013 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_886\_12\_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar